



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 86
Data: 27.09.2024

Bazuar në nenin 12, paragrafin 12.2 pika d, nenit 40, paragrafi 40.2 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L- 040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 61, paragrafi 61.2 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; neni 25, paragrafi 2 pika 2.2 dhe nenit 45, paragrafi 1.2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr. 50 të datës 28.06.2013, dhe në bazë të Qarkoreve Buxhetore 2024-01 dhe 2024-02 nga MFPT, Kuvendi i Komunës të Ferizajt, në seancën e mbajtur me datë: 27.09.2024 miratoi:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR VITIN 2025 DHE VLERËSIMET E HERSHME BUXHETORE 2026-2027

I

Me këtë vendim miratohet Buxheti i Komunës së Ferizajt për Vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme buxhetore 2026-2027

II

Shuma e buxhetit të Komunës së Ferizajt për Vitin 2025 e cekur në pikën I të këtij vendimi është 46,013,006.00€ dhe atë në kategori ekonomike si më poshtë:

Kategoritë buxhetore	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
1. Paga dhe shtesa	20,913,354.31 €	22,063,589.00 €	23,232,959.00 €
2. Mallra dhe shërbime	10,001,123.37 €	10,201,146.00 €	10,405,169.00 €
3. Shpenzimet komunale	719,694.00 €	752,080.00 €	789,684.00 €
4. Subvencione	2,050,000.00 €	2,152,500.00 €	2,324,700.00 €
5. Shpenzimet kapitale	12,328,834.32 €	13,142,186.00 €	13,933,911.00 €
TOTALI:	46,013,006.00 €	48,311,501.00 €	50,686,423.00 €

III

Pjesë përbërse e këtij vendimi është Buxheti i Komunës së Ferizajt për Vitin 2025 dhe vlerësimet e hershme buxhetore 2026-2027 në kuadër të të cilit është edhe tabela e përgjithshme e shpërndarjes së buxhetit

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Khavit Zariqi





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datë / Izlaze: Date / Dana: 01 / 10 / 2024		
Nr. Orgj. Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 87	Nr. Faqeve. Br. Strana: 2
Ferizaj - Uroševac		



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 87
Data: 27.09.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR KËMBIMIN E PJESËVE TË NGASTRAVE KADASTRALE; 784-0, 783-0 Z.K. MANASTIRC, PRONA PRIVATE, ME PJESËT E NGASTRAVE KADASTRALE 138-0, 130-0 Z.K. MANASTIRC, PRONA TË KOMUNËS SË FERIZAJT

I

Këmbehen pjesët e ngastrave kadastrale;

- 784-0 Z.K.Manastirc me sipërfaqe prej 384 m², pronë e Vebi (Sait) Ramusholli.
- 783-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe prej 1830 m² pronë e Vebi (Sait) Ramusholli.
- Pjesa e ngastres kadastrale 138-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe prej 151 m², pronë e komunës së Ferizajt dhe pjesa e ngastres kadastrale 130-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe prej 386 m² prone e Komunës së Ferizajt.

II

Pronat të cilat këmbehen janë të regjistruara parcela 784-0 Z.K.Manastirc në pronësi të Vebi Ramushollit me sipërfaqe prej 384 m², parcela 783-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe prej 1830 m² pronë e Vebi Ramushollit, kurse pjesa e parceles 138-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe prej 151 m² dhe pjesa e parceles 130-0 Z.K. Manastirc me sipërfaqe prej 386 m² është në pronësi të komunës. Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

III

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen për interes të përgjithshëm publik, respektivisht për rregullimin e parcelave si dhe me këtë këmbim krijohen kushte me të leta për qasje të parcelave me të cilat kufizohen .

IV

Pronat të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës me Nr. 01.Nr.08, të datës 29.02.2024, në bazë të të cilit vendim edhe është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Fianancave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 138-0 Z.K. Manastircë me sipërfaqe prej 151 m² pronë e komunës, është vlerësuar 30 € për m² parcela 138-0 Z.K. Manastircë me sipërfaqe prej 377 m² pronë e komunës së Ferizajt është vlerësuar 30€, kurse pronat private - parcela kadastrale 784-0 Z.K. Maastircë me sipërfaqe prej 384-m² është vlerësuar në shumën prej 35.€ për m², parcela 783-0 Z.K. Manastircë me sipërfaqe prej 1830 m² është vlerësuar 35€ për m², andaj në bazë të vlerësimit këmbimi paluejtshmërive do të bëhet ashtu siç është përcaktu në nenin I të këtij vendimi.

V

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen në librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës - Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJT
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Datëse / Izlaze: Date / Dana: 01 / 10 / 2024
Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 88 Nr. Fajrove. 1
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.



Ferizaj - Uroševac
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 88
Data: 27.09.2024**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT 2023-2027, 01.NR.62 I DATËS
30.06.2023 TË KUVENDIT TË KOMUNËS.**

I

Shfuqizohet vendimi i Planit të Integritetit 2023-2027 i evidentuar si vendimi me Nr.01.Nr.62 i datës 30.06.2023 i Kuvendit të Komunës Ferizajt.

II

Arsyeja e shfuqizimit të këtij vendimi është pasi që agjencia për parandalimin e korrupsionit ka miratuar Planin e Integritetit dhe i cili nuk është në përputhje me vendimin Nr.01.Nr.62 të Kuvendit të Komunës së Ferizajt.

III

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi i Komunës së Ferizajt.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRVA ADMINISTRACIJE TOSOBILJA		
Dalesë / Izlaze: Date / Dana: 01.10.2024		
No. Org. 01	No. Prot. 89	Tir. F. qave. 2
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 89
Data: 27.09.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE;
1199-40, 1199-43, 1199-16, 1199-19 DHE 1199-21, 1059-3, 1059-6, 1059-5, 1263-0 DHE 1264-0 Z.K.
PRELEZ I JERLIVE PRONË PRIVATE**

I

Shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik pjesët e ngastrave kadatsrale:

- 1199-40 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 2835 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi)Zymberi Bytyqi.
- 1199-43 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 2664 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-16 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 33 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-19 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 36 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-21 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 99 m², pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1221-6 me sipërfaqe prej 1454 m² pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-30 me sipërfaqe prej 160 m² pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1199-31 me sipërfaqe prej 143 m² pronë e Egzon (Xhavit) Zymberi dhe Florentina (Nijazi) Zymberi Bytyqi.
- 1263-0 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 297 m², pronë e Blerim Hyseni.
- 1264-0 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 982 m², pronë e Blerim (Raif) Hyseni-Qirambajtje 99 vite.

- 1059-5 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 835 m², pronë e Blerim (Raif) Hyseni-Qirambajtje 99 vite.
- 1059-3 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 467 m², pronë e Pasuri Shoqërore Kombinati Bujësor Industrial.
- 1059-6 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 235 m², pronë e Pasuri Shoqërore Kombinati Bujësor Industrial.

II

Ngastrat kadastrale Shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim të hapjes së rrugës për krijim e qasjes në parcelën kadastrale 1064-1 Z.K. Prelez i Jerlive në të cilën Komuna e Ferizajt planifikon të implementoj parkun si dhe njëkohësisht lidhen rrugët e Fshatit Muhoc me Fshatin Prelez i Jerlive.

III

Pjesa e parcelës kadastrale 1199-40, 1199-43, 1199-16, 1199-19 dhe 1199-21 Z.K. Prelez i Jerlive propozohen që të këmben me pjesën e ngastrës kadastrale 1064-1 Z.K. Prelez i Jerlive, ngastra kadastrale 1263-0, 1264-0 dhe 1059-5 Z.K. Prelez i Jerlive propozohen që të këmben me pjesën e ngastrës kadastrale 1057-0 dhe 1064-1 Z.K. Prelez i Jerlive, ndërsa parcelat kadastrale 1059-3 dhe 1059-6 Prelez i Jerlive do të shpronësohen përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës, sepse të njëjtat janë prona nën menaxhimin e AKP-së, arsyeja pse parcelat kadastrale janë propozuar që të këmben janë se Komuna e Ferizajt nuk ka të planifikuar buxhet për shpronësim për këtë projekt.

IV

Pronat të cilat shpallen interes i përgjithshëm – publik janë të regjistruara 1064-1 dhe 1057-0 Z.K. Prelez i Jerlive në pronësi të Komunës së Ferizajt, parcelat kadastrale 1199-40, 1199-43, 1199-16, 1199-19 dhe 1199-21 Z.K. Prelez i Jerlive në pronësi të Egzon (Xhavit) Zymeri dhe Florentina (Nijazi) Zymeri Bytyqi, në këto parcela janë të regjistruara disa të drejta të servitutit, parcela kadastrale 1263-0, pronë private Blerim Hyseni e cila është në Hipotekë në Pro Credit Bank 1264-0 dhe 1059-5 Z.K. Prelez i Jerlive në pronësi të Blerim Hyseni-Qirambajtje 99 vite, 1059-3 dhe 1059-6 Prelez i Jerlive Pasuri Shoqërore Kombinati Bujësor Industrial nën menaxhimin e AKP-së në këto parcela nuk ka ndonjë kontest apo vërejtje.

V

Obligohet Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj sqarime për të drejtat në njësit kadastrale në të cilat ekziston Servituti si dhe Pëlqimin nga Banka për këmbim si dhe vlerësim të njërive kadastrale të përshkruara më lart nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njërive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njërive.

VI

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

VII

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VIII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Datëse / Izazmë: Date / Dena: 01 / 10 / 2024

Nr. Orgj. / Org. jed: 01	Nr. Prot. / Br. Prot.: 92	Nr. Faqeve. / Br. Strana: 2
--------------------------	---------------------------	-----------------------------

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVË • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 92
Data: 27.09.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit me numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr.09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE;
2039-1 Z.K. SOJEVË, PRONË PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E
NGASTËRËS KADASTRALE 1378-1 Z.K. SOJEVË, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.**

I

Shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik pjesa e ngastrës kadastrale:

- 2039-1 Z.K. Sojevë, me sipërfaqe prej 182 m², pronë e Faruk Nebihut

II

Ngastrat kadastrale të lartëcekura Shpallet Interes i Përgjithshëm-Publik me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1378-1 Z.K.Sojevë interesi publik është zgjerimi i rrugës në Fshatin Sojevë Lagjja "Sylovit" rruga "Zejnullah Zejna"

III

Pronat të cilat shpallen interes i përgjithshëm – publik janë të regjistruara: 2039-1 Z.K. Sojevë, me sipërfaqe prej 182 m², pronë e Faruk Nebihut, si dhe parcela me numër kadastri 1378-1 Z.K.Sojevë pronë e Komunës së Ferizajt, Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

IV

Obligohet; Kryetari i Komunës – Drejtorja e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njëjësive kadastrale të përshkruara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë dhe pas vlerësimit të njëjësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njëjësive.

V

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejshmërive.

VI


Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UDRËJA ADMINISTRATIVE TË SOBELJA

DATE: 01/10/2024

Nr. Org. 01 Nr. Prot. 93



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 93
Data: 27.09.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT ME NR.01.NR.69 TË DATËS 31.07.2024 DHE ANULIMIN E PJESËRISHËM TË VENDIMIT ME NR.01.NR. 09 TË DATËS 03.02.2017

I

ANULOHET - Vendimi me Nr.01.Nr.69 të datës 31.07.2024, përmes së cilit i është bartë aset (Fabrika e Ujit) në Talinoc të Muhaxherëve, Kompanisë rajonale të Ujësjetës K.R.U. "Bifurkacioni".

II

ANULOHET; Pjesërisht Vendimi me Nr.01.Nr.09 i datës 03.02.2017 përmes së cilit është destinuar në tërësi parcela kadastrale 992-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve me sipërfaqe 20380 m² për ndërtimin e Fabrikës së ujit, Vendimi me Nr.01.Nr.09 i datës 03.02.2017 anulohet për pjesën e parcelës e cila nuk është përfshirë në projektin e Fabrikës së ujit dhe atë për sipërfaqen 12454 m².

III

Obligohet; Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi t'i bëjë ndarjen e parcelës dhe regjistrimin e tyre në operatin kadastral sipas këtij vendimi.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit e Komunës së Ferizajt.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 94
Data: 27.09.2024**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRËS KADASTRALE 2435-1 DHE 2435-2 Z.K.FERIZAJ, PRONË PRIVATE ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 180-10 Z.K.TALINOVC I JERLIVE PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

I

Shpallen interes i përgjithshëm – Publik pjesët e ngastrës kadastrale:
2435-1 Z.K.Ferizaj me sipërfaqe 115m², me titular Bujar (Vehbi) Avdiu me Nr.Personal 1011583233 dhe Imrane (Rexhep) Avdiu me Nr.Personal 1004473716, dhe
2435-2 me sipërfaqe prej 35m², me titular Bujar (Vehbi) Avdiu me Nr.Personal 1011583233 dhe Imrane (Rexhep) Avdiu me Nr.Personal 1004473716.

II

Ngastrat e lartëcekura shpallen interes i përgjithshëm me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 180-10 Z.K.Talinovc i Jerlive, këto prona do të këmben për interes public, pasi në parcelat e pronës private që shpallen interes i përgjithshëm me këtë vendim është implementuar projekti i parkut i emërtuar “Fjala e lirë” i cili ndodhet mbrapa objektit të KEDS-it, në këto prona nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

III

Obligohet; Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkojë vlerësim të njësive kadastrale të përshkuara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Keëbim të këtyre njësive.

IV

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmëive.

V

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.


VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

Ferizaj - Uroševac

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 95
Data: 27.09.2024

Në bazë të nenit të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR ANULIMIN E VENDIMIT ME NR.01.NR.111 I DATËS 31.08.2022 DHE ANULIMIN E
VENDIMIT ME NR.01.NR.48 I DATËS 30.05.2024.**

I

ANULOHET - Vendimi me Nr.01.Nr.111 i datës 31.08.2022 dhe Vendimi me Nr.01.Nr.48 i datës 30.05.2024 me të cilin është plotësuar-ndryshuar vendimi me Nr.01.Nr.111 i datës 31.08.2022 përmes të cilëve është shpallur interes i përgjithshëm ngastra kadastrale 498-7, respektivisht pas ndarjes se parceles 3487-3 Z.K.Ferizaj.

II

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi
Xhavit Zariqi



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 96
Data: 27.09.2024**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, të Ligjit Nr. 03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT - PARCELËS PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT I CILI DO TË
SHËRBEJË PËR NEVOJAT E BANORËVE TË FSHATIT KOMOGLLAVË**

I

Lokacioni për ndërtimin e objektit dhe shfrytëzimit për hapësirë gjelbëruese, parking dhe çasje në objekt të cilin pjesërisht do të ndërtohet në pjesë private në Fshatin Komogllavë Lagjja “Mulla Ademi” caktohet në parcelën kadastrale 2671-0 Z.K Komogllavë me sipërfaqe prej 3.7 ari (370 m2), pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Obligohet - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Komogllavë.

III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e objektit do të bëhet nga banorët e Fshatit Komogllavë, Lagjja “Mulla Ademi”

IV

Obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje të veçantë për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të këtij objekti me Kryetarin e Fshatit Komogllavë, ashtu siç e parasheh Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funkionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 9 paragrafi 1, pika 1 deri 5.

V

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VI

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 97
Data: 27.09.2024**

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, të nenit 6, neni 21 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 5, neni 13, neni 24, neni 25 të Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PJESËS SË PARCELËS KADASTRALE 992-0 Z.K. TALINOVC I MUHAXHERËVE DHE OBJEKTIT - FABRIKËS PËR PRODHIM TË UJIT E NDËRTUAR NË KËTË PARCELË SUBJEKTIT JURIDIK-KOMPANISË RAJONALE K.R.U. "BIFURKACIONI"

I

I ipet në shfrytëzim afatgjatë pjesa e ngastrës kadastrale me Nr.P-72217060-00992-0 Z.K.Talinovc i Muhaxhërëve me sipërfaqe prej 7926 m², dhe Objektit – Fabrikës së Ujit të ndërtuar në këtë ngastër pronë e Komunës së Ferizajt, subjektit juridik-kompanisë publike K.R.U. "Bifurkacioni" me numër identifikues 810663353, me adresë në Ferizaj, Rr."Enver Topalli", aksionar Qeveria e Republikës së Kosovës.

II

Ngastra kadastrale me objekte përcjellëse i ipet në shfrytëzim K.R.U. "Bifurkacioni" me qëllim të shfrytëzimit për përpunim dhe furnizim me ujë banorët e Komunës së Ferizajt.

III

Afati për dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale me objekt të përshkruara më lartë, është 99 vite.

IV

Ngastra kadastrale e përshkruar më lartë me objekt përcjellës ipen në shfrytëzim pa kompensim.

V

Pas miratimit të vendimit nga Kuvendi Komunal, Kuvendi e autorizon kryetarin e komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratën me subjektin juridik K.R.U. "Bifurkacioni".

VI

Obligohet - Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në operativë kadastral pas plotësimit të kushteve ligjore dhe nënshkrimit të kontratës.


VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi



**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 98
Data: 27.09.2024**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 17 pika 7 Ligji Nr. 08/L-125 për Pronën Publike dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2024 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR DHËNIE TË PËLQIMIT STACIONIT TË AUTOBUSËVE SH.A. PËR DHËNIE NË
SHFRYTËZIM TË LOKALEVE AFARISTE.**

I

I ipet pëlqimi Kompanisë Publike “Stacioni i Autobusëve” SH.A. për dhënien me qira të lokaleve afariste të cilat janë në kuadër të objektit të “Stacionit të autobusëve i ndërtuar në parcelën kadstrale 489-9 Z.K Ferizaj e cila i është dhënë në shfrytëzim N.P.L. Stacionit të Autobusëve” SH.A. në bazë të Vendimit me Nr.01.Nr. 81 të datës 30.08.2024 në kohëzgjatje prej 50 viteve.

II

Lokalet afariste mund të ipen me qira sipas Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullore (Qrk) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

III

Afati për dhënie me qira nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vite.

IV

Çmimi fillestar për 1m² është 20.00€.

V

Procedura e dhënies me qira do të jetë përmes ankandit publik dhe fitues shpallet ofertuesi me çmimin më të lartë.

VI

Obligohet - Menaxhmenti i Kompanisë Publike “Stacioni i Autobusëve” SH.A. që t’i paraqes raport të veçantë çdo 6 muaj Kuvendit të Komunës – Kryetarit të Komunës për mënyrën e shfrytëzimit të lokaleve afariste ashtu siç e parasheh ligji Ligji Nr. 06/L-092 dhe Rregullorja (Qrk) Nr. 09/2020.

VII

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër.

VIII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi